

V E N D I M
Nr.557, datë 21.11.1994

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.453,DATË
26.9.1994 “PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.453, datë 26.9.1994 “Për dhënien e ndihmës ekonomike”, në pikën 2, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Përfshihet, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike të plotë mujore për familjen me një anëtar merret në konsideratë 70 për qind e së ardhurës së saj, në të cilën përfshihet pagesa e papunësisë së një personi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi